




CILËSIA E UJËRAVE DHE MBROJTJA E TYRE



Tiranë, 2025


Liqenet, pellgjet, lumenjtë dhe përrenjtë mbështesin ekosistemet dhe sigurojnë habitat për shumë specie bimore dhe shtazore. Gjithashtu shërbejnë për përdorime njerëzore, duke përfshirë ujin e pijshëm, ujitjen, trajtimin e ujërave të zeza, blegtorinë, përdorimet industriale, hidrocentralet dhe rekreacionin. Ujërat e ëmbla sipërfaqësore gjithashtu ndikojnë në shtrirjen dhe gjendjen e burimeve të tjera ujore, duke përfshirë ujërat nëntokësore, ligatinat dhe sistemet bregdetare.

Ujërat sipërfaqësorë dhe ata nëntokësorë janë në parim burime natyrore të rinovueshme. Këto burime, përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të furnizimit të popullsisë me ujë të pijshëm në Shqipëri. Kuptimi i këtyre trupave ujorë dhe menaxhimi i tyre është thelbësor për adresimin e sfidave të ndryshme mjedisore dhe shoqërore.

Efektet direkte ose indirekte të nutrienteve në mjediset ujore dhe sasia e tyre ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore. Pjesa më e madhe e ndotësve kimik e kanë origjinën nga aktivitetet njerëzore dhe shkarkimi i ujërave urbane të pa trajtuara.

Praktikat efektive të menaxhimit mund të ndihmojnë në maksimizimin e përfitimeve të këtyre burimeve ujore, duke minimizuar ndikimet negative të ndotjes, përdorimit të tepërt dhe ndryshimeve klimatike. Angazhimi me praktika të qëndrueshme do të jetë çelësi për ruajtjen e këtyre burimeve të vlefshme për brezat e ardhshëm.

Forcat shtytëse presioni, ndikimi, gjendja, reagimet për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore



Vështrim mbi cilësinë e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore në vendin tonë



Ujërat sipërfaqësore

- **Basenet**

Cilësia e ujërave të baseneve për parametrat fiziko-kimik (oksigeni i tretur, amoniak, nitrite, nitrate, ortofosfate, fosfori total, nevoja kimike për oksigjen, nevoja biokimike për oksigjen)

- Klasa I - Gjendje e lartë
- Klasa II - Gjendje e mirë
- Klasa III - Gjendje e moderuar
- Klasa IV - Gjendje e varfër
- Klasa V - Gjendje e keqe


Viti	Baseni Drini-Bunë	Baseni Ishëm- Erzen	Baseni i Shkumbinit	Baseni i Semanit	Baseni i Vjosës	Baseni i Matit
2018	Klasa III	Klasa V	Klasa IV	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2019	Klasa IV	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa III	Klasa II
2020	Klasa IV	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2021	Klasa IV	Klasa V	Klasa II	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2022	Klasa III	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa II	Klasa II
2023	Klasa IV	Klasa V	Klasa III	Klasa IV	Klasa II	Klasa II

Treguesit e pranisë së ndotjes radioaktive në ujë janë përqëndrimi i aktiviteit alfa/beta total.

Radionuklidet natyrore: Uranium – 238, Uranium – 234, Radium – 226, Radium – 228, radionuklidet artificiale: Karbon -14, Stroncium – 90, Plutonium 239/240, Americium – 241, Kobalt – 60, Cezium -134, Cezium – 137, Jod – 131.

Për nivelin e ndotjeve radioaktive (aktiviteti alfa/beta total) të ujërave të lumenjve Drin, Mat, Erzen, Shkumbin dhe Vjosë të monitoruar gjatë vitit 2023 rezulton se vlerat e aktivitetit alfa/beta total janë nën vlerat e përcaktuara në standartet ndërkombëtare (KE) dhe kombëtare për ujin e pijshëm.

Liqenet



Tributarët e liqenit të Ohrit

Viti	Lumi i Pogradecit	Lumi i Vërdovës	Lumi i Tushemishtit
2018	Klasa II- Gjendje e mirë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa II- Gjendje e mirë
2019	Klasa II- Gjendje e mirë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa II- Gjendje e mirë
2020	Klasa II- Gjendje e mirë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa I - Gjendje e lartë
2021	Klasa I - Gjendje e lartë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa I - Gjendje e lartë
2022	Klasa II- Gjendje e mirë	Klasa IV- Gjendje e varfër	Klasa II- Gjendje e mirë
2023	Klasa II- Gjendje e mirë	Klasa III- Gjendje e moderuar	Klasa I - Gjendje e lartë

Vlerësimi i cilësisë së baseneve dhe liqeneve për metalet e rënda (Cd, Pb, Cu, As, Hg)

	2022	2023
Basenet		
Baseni Drini - Bunë	Ujerat e baseneve klasifikohen në A1- cilësi shumë të mirë	A1 -cilësi shumë e mirë
Baseni Ishëm - Erzen		A2- cilësi e mirë
Baseni i Shkumbinit		A1- cilësi shumë e mirë
Baseni i Semanit		A2- cilësi e mirë
Baseni i Vjosës		A2- cilesi e mirë
Baseni i Matit		A2- cilesi e mirë
Liqenet		
Liqeni i Shkodrës	Ujerat e baseneve klasifikohen në A1- cilësi shumë të mirë	-
Liqeni i Ohrit		A1- cilësi shumë e mirë
Liqeni i Prespës		-

Cilësia e ujërave nëntokësore

Baseni	2020-2022	2023
Drin	<p>Rezulton se ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira . Janë ujëra të ëmbla, të buta dhe të tipit alkalin të dobët.</p> <p>Takohet përmbajtje e rritur e NH₄ në <i>Akuiferin e Mbishkodrës</i> në zonën e Nënshkodrës si Blinisht dhe Velipojë, si dhe në zonën Hot i Ri dhe Grudë Fushë - Koplik Shkodër. Kjo situatë ka lidhje me mos zbatimin e zonave sanitare dhe përmytjet.</p>	<p>Ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Ka përmbajtje mbi norme të NH₄ në stacionin e Lezhes Shëngjinit dhe Rrilë.</p>
Mat	<p>Ujërat nëntokësore në përgjithësi janë të mira. Janë ujëra të ëmbla, të buta e mesatarisht të forta dhe të tipit alkalin të dobët. Vihet re prezenca e NO₂, në shpimet Patok dhe Hoteli i Gjuetisë e cila vjen nga mos zbatimi i zonave të rreptësisë sanitare. Në akuiferin poroz të</p>	<p>Ujerat kane veti fiziko - kimike të mira. Takohet përmbajtje mbi normë të pH, Na, Cl, NH₄ në Hotelin e Gjuetise dhe Na, Cl në Patok-Laç.</p>

Milot - Fushë-Kuqes, takohet vlerë e lartë e klorit në shpimin 177 dhe 502 Patok për arsye se këto shpime janë pikat më ekstremale në drejtim të perëndimit dhe në breg të detit Adriatik.

Erzen-Ishëm	Ujërat nëntokësore të këtij baseni në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Janë ujëra të ëmbla, të fortë deri në shumë të fortë dhe alkaline të dobët. Takimet e joneve NH ₄ , NO ₂ , NO ₃ , në ujë tregojnë që janë ndotje lokale dhe lidhen me moszbatimin e zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare.	Ujërat nëntokësore të këtij baseni në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Ne disa stacione paraqitet fortesi e lartë.
Shkumbin	Rezulton se ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Janë ujëra të ëmbla deri në të freskëta, mesatarisht të forta deri në shumë të forta dhe të tipit alkaline të dobët. Shfaqja e përmbajtjes së NO ₂ , NO ₃ dhe NH ₄ lidhet me moszbatimin e zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare të shpimeve.	Ujërat kanë veti fiziko - kimike të mira. Ka përmbajtje mbi normë të Mg, NH ₄ , Fp ne stacionet metalurgjik-Vidhas, Konjat-Lushnje, Çërme -Lushnje.
Seman	Ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Janë ujëra të ëmbla, të buta dhe të tipit alkaline të dobët. Nuk ka ndotje masive të akuifereve ujëmbajtëse. Në ndonjë rast vihet re prezenca e NO ₂ , por në vlera të ulëta, e cila vjen nga moszbatimi i zonave të rreptësisë sanitare.	Ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Ka përmbajtje mbi normë të Fe në stacionin Çiflig. Përmbajtje mbi normë të Mg, Fp në Kozarë, Otlak, Lapardha.
Vjosa	Rezulton se ujërat nëntokësore në akuiferët e basenit Vjosë kanë veti fiziko - kimike të mira. Janë ujëra të freskëta, të tipit alkaline të dobët, mesatarisht të forta. Nuk ka ndotje masive të akuifereve ujëmbajtëse. Përjashtim bën shpimi në Pish - Poro ku në të dyja fazat e monitorimit për të tre vitet, vlerat e Mp, Fp, Na, NH ₄ , NO ₂ janë mbi normën e lejuar për ujë të pijshëm.	Ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike shumë të mira. Përjashtim bën stacioni Pish Poro me përmbajtje mbi normë të Na, Mg, Cl, NH ₄ mbi normë, të lartë, Mth, Mp , Fp. Eshtë jashtë normave për ujë të pijshëm.
Zona Jonike	Ujërat nëntokësore janë ëmbla e të freskëta, të tipit alkaline të dobët, mesatarisht të forta. Nuk kanë përmbajtje të NH ₄ , NO ₂ , NO ₃ .	Ujërat nëntokësore kanë veti shumë të mira fiziko-kimike.

Si mund të mbrojmë cilësinë e ujërave?

Cilësia e lumenjve kryesorë të Shqipërisë ka ndikim në cilësinë e ujërave nëntokësore, të deteve dhe në ekosistemet ujore. Për përmirësimin dhe ruajtjen e tyre kërkohet angazhimi i të gjithëve :




Secili nga Ne, në jetën e përditshme duhet të kujdeset që të:

- Mos derdhë mbetje të rrezikshme në kanalizimet e ujërave të ndotura apo në tokë. Kjo mund të ndotë tokën, ujërat nëntokësore ose ujërat sipërfaqësore aty pranë. Një gamë produktesh të përdorura në shtëpi përmbajnë substanca të rrezikshme ose toksike që mund të ndotin ujërat nëntokësore ose sipërfaqësore, të tilla si: vaj motori, pesticidet, bojëra të mbetura ose kanaçe bojërash, pastruesit e shtëpisë, një sërë ilaçesh etj.
- Kufizojë përdorimin e pesticideve ose plehrave dhe të ndjekë gjithmonë udhëzimet e etiketës. Shumë plehra dhe pesticide përmbajnë kimikate të dëmshme të cilat mund të udhëtojnë nëpër tokë dhe të ndotin ujërat nëntokësore ose të rrjedhin në ujërat në lumenj, përrenj dhe liqene.
- Mos derdhë ilaçet farmaceutike në lavaman ose tualet. Ilaçet me recetë dhe ato pa recetë të derdhura në lavaman ose të derdhura në tualet mund të kalojnë përmes sistemit të trajtimit dhe të hyjnë në lumenj dhe liqene. Këto burime ujore mund të deperojnë në rrjedhën e poshtme të furnizimit me ujë të pijshëm të komunitetit. Impiantet e trajtimit të ujit në përgjithësi nuk janë të pajisura për të hequr në mënyrë rutinore ilaçet.
- Inkurajojë programet e grumbullimit dhe të kthimit farmaceutik që pranojnë ilaçe me recetë ose pa recetë, pasi këto programe ofrojnë një mënyrë të sigurt dhe të ndërgjegjshme për mjedisin për të asgjësuar ilaçet e padëshiruara.
- Mos derdhë mbeturina në brigjet e lumenjve gjatë kryerjes së aktiviteteve argëtuese familjare.

Pushteti qendror dhe lokal duhet të ndërmarrë veprime për të:

- Mënjanuar dhe minimizuar shkaktarët e ndotësve pasi impakti kryesor janë shkarkimet urbane dhe ato industriale të cilat derdhen direkt në lumenj, liqene apo edhe në zona bregdetare.
- Ndaluar shfrytëzimin e inerteve pa kriter në brigjet e lumenjve.
- Respektuar standartet e përcaktuara nga Legjislacioni Shqiptar për shkarkimet e lëngëta nga subjektet prodhuese në ujërat pritës sipërfaqësorë.
- Kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e ligjit.
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve për mos-përdorimin e lumenjve si vend-depozitime.
- Vënë në funksionim me efikasitet të plotë dhe zgjerimi i kapaciteteve të impianteve të trajtimit të ujërave urbane ekzistuese si dhe ngritja e impianteve të rinj.

Çfarë duhet bërë për ruajtjen e ujërave nëntokësore?



Marrja e sasive të mëdha të ujit (mbi ato që merren aktualisht) nuk duhet të bëhet pamiratimin e specialistëve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar sepse do të aktivizonte rrymat e mineralizuara dhe mund të kishim një prishje të cilësisë së ujërave që aktualisht janë të pijshëm.

Ndërmarrjet e Ujësellsave të zbatojnë zonat e rreptësisë sanitare rreth shpimeve të shfrytëzimit, të marrin masa për pastrimet e kanaleve kulluese që shpesh herë mbushen me mbeturina që infiltrojnë dhe ndotin akuiferët.


Zbatimin e zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare rreth shpimeve të shfrytëzimit për mbrojtjen e ujërave nëntokësorë nga ndotjet sipërfaqësore.

Inventarizimi i shpimeve pa leje në akuiferët kuaternarë, për të patur mundësi të kryerjes së bilancit të shfrytëzimit të akuiferëve.

Klorinimi i ujit duhet të jetë i vazhdueshëm në stacionet e pompimit si dhe mbajtja nën monitorim të vazhdueshëm.

Agjencitë ligjzbatuese të kontrollojnë, monitorojnë e ndalojnë depozitim, hedhjen e mbeturinave urbane në shtretërit e lumenjve për ruajtjen e cilësisë së ujërave nëntokësore, pasi këto janë dhe zonat e ushqimit të akuiferëve ujëmbajtës.

Ndalimi i shfrytëzimit të zhavorreve në shtretërit e lumenjve për mbrojtjen e shpimeve të shfrytëzimit në tarracat lumore dhe ruajtjen e ekuilibreve hidrodinamike e hidrokimike të ushqimit të akuiferëve ujëmbajtës.



Përgatiti dhe publikoi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Adresa: Rruga “Sami Frashëri” Nr. 4, Tiranë;

Web: www.akm.gov.al